



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 395/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës- Murat Hoxha nga subjektit politik Lidhja Demokratike Kosovës (LDK), dega në Gjilan, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës – Murat Hoxha nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Gjilan.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 27.06.2014, nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës- Murat Hoxha të subjektit politik LDK me nr. 31 në Gjilan, me të cilën pretendohet se në bazë të informacioneve të sigurta dhe raporteve të vëzhguesve të LDK-së se në Qendrën e Votimit 0430d/01R, se kandidati me nr.31, ka 67 vota dhe të cilat u janë regjistruar gabimisht kandidates me nr 30 nga i njëjti subjekt politik. Parashtruesi i ankesës kërkon që ky gabim teknik të korrigjohet ashtu që ti regjistrohen 67 vota nga vendvotimi 0430d/01R.

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e dëshmisë ka bashkangjitur si provë raportin e KKZ-së dhe dy raportet e vëzhguesve .

Bazuar në nenin 117. 2 të LZP-së PZAP-i “*Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme* “

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri administrimin e materialit zgjedhor konstatoi se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga kandidati për deputet-Murat Hoxha të subjekti politik LDK në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për ta bërë administrimin e hetimeve të materialit zgjedhor në QNR, për të cilat kandidati në fjalë pretendon se nuk ju kanë proceduar 67 votat të tij në FRK nga anëtarët e vendvotimit 0430d/01R dhe bartja e votave të tij tek kandidatja me nr. 30.

PZAP-i pas hetimeve të bëra lidhur më rastin në fjalë ka konstatuar nga FRK-ja origjinale në QNR, se janë të shënuara 71 vota lidhur me VV 0430d/01R, për kandidatin në fjalë, e jo ashtu siç pretendohet në ankesë që nuk është shënuar asnjë votë.

Për tepër rezultati i VV të lartpërmendur, i njëjti është përfshirë në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të publikuar nga KQZ-ja.

Andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së lidhur me ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 395/2014 më datën 30.06.2014



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*